

**Komentet e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së, Ambasadori Eugen Wollfarth, mbi reformën elektorale dhe çështjen e imunitetit, Universiteti Bedër, Tiranë**

13 mars 2012

**Pyetje:** Të gjithë jemi dëshmitarë se sa herë që zhvillohen zgjedhje, ka një reformë zgjedhore që sjell ndryshime. A ndikojnë pozitivisht këto ndryshime dhe çfarë pritet të ndodhë këtë vit me Reformën Zgjedhore?

**Ambasadori Wollfarth:** “Reforma e Kodit Zgjedhor është shumë e rëndësishme, para së gjithash për të dhënë një tablo të qartë teknike fotografike se çfarë duan zgjedhësit ditën e zgjedhjeve. Sidomos në zgjedhjet e fundit, situata ishte veçanërisht e ndërlikuar, për shkak se pati më shumë se sa një *foto finish* këtu në Tiranë, në kryeqytet, i cili ngriti disa çështje të tjera të paparashikuara në Kodin Zgjedhor, si për shembull se çfarë duhej bërë me fletët e votimit të hedhura jo në kutitë e caktuara. Kjo tregon se disa çështje shumë teknike si hedhja e votave mund të politizohen shumë në rastin e rezultateve shumë të afërta, duke ndikuar te rezultati. Ky është thjesht një shembull praktik nga një listë më e gjatë çështjesh që OSBE/ODIHR-i, përmes Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, ka rekomanduar që të rishikohen në kuadrin e procesit të reformës së Kodit Zgjedhor. Tashmë, me përvojën e zgjedhjeve të kaluara dhe zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009, del si detyrë përmirësimi i Kodit Zgjedhor, në mënyrë që KQZ-ja të jetë në një pozicion më të mirë teknik për t'u shërbyer qytetarëve, ku përfshihen sigurisht edhe partitë politike. Kjo duhet të ndihmojë në rritjen e besimit të qytetarëve te sistemi, besimin se votat e tyre janë të rëndësishme dhe se ato numërohen siç duhet për një rezultat të besueshëm, si në zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe në ato vendore. Tashmë është shumë e rëndësishme që të ruhet interesimi i qytetarit të zakonshëm dhe që koha të përdoret me efikasitet. Ju mund të keni lexuar ose dëgjuar se afati i Komisionit të posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore është shtyrë deri në fund të prillit për të dalë me propozime të hartuara bashkërisht për Kodin e ardhshëm Zgjedhor. Është gjithashtu shumë e rëndësishme të krijohet besimi midis partive në mënyrë që KQZ-ja të funksionojë siç duhet dhe në mënyrë krejtësisht teknike. Kjo do të çlirojë akoma më shumë energji edhe për pjesë të tjera të procesit të vazhdueshëm të reformave shumë të rëndësishme, i cili, e theksoj, është shumë i rëndësishëm për integrimin evropian. Ndër këto reforma mund të përmend si më të rëndësishmet reformën në drejtësi dhe reformën parlamentare”.

**Pyetje:** Zoti Rama pranoi që të votojë edhe heqjen e imunitetit si pjesë e reformës në drejtësi. Deklarata shkon në sinkron me atë të kryeministrit dhe Kryetares së Kuvendit. Ju si e shihni këtë lëvizje?

**Ambasadori Wollfarth:** “Ky është një kontribut i rëndësishëm në një diskutim jashtëzakonisht të rëndësishëm. Imuniteti duhet të përdoret vetëm për t'u shërbyer njerëzve dhe për asgjë tjetër; dhe duhet të ketë kufij. Unë jam në favor të një zgjidhjeje dhe votimi të shpejtë”.

**Pyetje:** Mendoni se klasa politike ka gjetur tashmë rrugën e bashkëpunimit dhe komunikimit? Mendoni se jemi afër statusit të vendit kandidat për Bashkimin Evropian apo ka diçka më shumë që ne nuk e dimë?

**Ambasadori Wollfarth:** “Mund të përgjigjem vetëm nga këndvështrimi i Prezencës së OSBE-së, se [statusi i vendit kandidat] është shumë më afër, por mbetet gjithashtu ende shumë punë për të bërë. Procesi i reformave duhet të vazhdojë – reforma zgjedhore, parlamentare dhe reforma në drejtësi, për të përmendur vetëm më të rëndësishmet. Unë sigurisht që uroj të ketë një rekomandim pozitiv, por në fund vendimi i takon Komisionit, i cili ia paraqet rekomandimin e tij shteteve anëtare të BE-së”.

**Pyetje:** Për sa i përket imunitetit, mendoni se është më mirë ndërhyrja në Kushtetutë apo varianti i maxhorancës me dorëheqje individuale të imunitetit?

**Ambasadori Wollfarth:** “Jam i sigurt që bashkërisht mund të gjendet një zgjidhje e mirë në parlament. Kushtetuta nuk duhet prekur çdo ditë”.